



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 152, Datë 28.05.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 91, DATË 02.04.2026
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DION ENERGJI” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693 prot., datë 26.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026 “Mbi licencimin e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW”

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “DION ENERGJI” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 02.04.2026 vendosi të licencojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.05.2026, ndërsa në pikën 4 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Për vendimin e sipërcituar, shoqëria është njoftuar me shkresën e ERE-s me nr. 667/8 prot., datë 20.04.2026, me anë të së cilës i janë sjellë në vëmendje dhe kushtet e vendimit.
- Nga të dhënat që ERE disponon, në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria “DION Energji” sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin prill 2026, pra brenda afatit të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s.
- Në këto kushte, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 91/2026, duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2 të vendimit nr. 91/2026, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, si vijon: *Ky vendim është objekt rishikimi në rast të*

përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, , si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 91, datë 02.04.2026, si vijon:
 - a) Pika 2 e vendimi të bordit nr. 91, datë 02.04.2026, *shfuqizohet.*
 - b) Pika 4 e vendimi të bordit nr. 91, datë 02.04.2026, ndryshon dhe bëhet: *“Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI